



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.3 të Ligjit nr. 04/L-155 për sistemin e pagesave, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2015, miratoi këtë:

## **Rregullore për Kliringun dhe Funksonimin e Llogarive për Shlyerje**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i Rregullores për Kliringun dhe Funksonimin e Llogarive për Shlyerje (tani e tutje “Rregullorja”) është të përcaktojë rregullimin e procedurave të kliringut të brendshëm të urdhërpagesave të dhëna nga pjesëmarrësit në sistem, të shprehura me vlera në EUR dhe operimin e llogarive për shlyerje në EUR të mbajtura në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termat e përkufizuara në Ligjin për BQK-në, Ligjin për sistemin e pagesave dhe siç janë përkufizuar më poshtë në këtë Rregullore.
  - 1.1. “Bankë” nënkupton një subjekt të përcaktuar me Ligjin nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare;
  - 1.2. “Pjesëmarrës në sistem” nënkupton anëtarin e një sistemi të pagesave të kliringut apo shlyerjes së letrave me vlerë apo palën e një marrëveshje, që themelon një sistem. Kjo mund të përfshijë pjesëmarrësit jo të drejtëpëdrejtë.
  - 1.3. “Pjesëmarrës i drejtëpëdrejtë” nënkupton një pjesëmarrës në një sistem të transferit, që mund të kryejë të gjitha aktivitetet e lejuara në sistem pa përdorur ndonjë ndërmjetësues (duke përfshirë në veçanti dërgimin direkt të urdhërpagesave në sistem);
  - 1.4. “Pjesëmarrës jo i drejtëpëdrejtë” nënkupton një pjesëmarrës në sistemin e transferit të mjeteve apo të letrave me vlerë, i cili ka marrëdhënie kontraktuese dhe përdor një pjesëmarrës të drejtëpëdrejtë, si ndërmjetësues me qëllim që të kryejë disa nga aktivitetet e lejuara në sistem;

- 1.5. “Dita bankare” nënkupton një ditë ose pjesë të saj gjatë së cilës pjesëmarrësit në sistem janë të hapur për pranimin, përpunimin, transferin e urdhërpagesave dhe porosive tjera të lidhura me transaksionet e pagesave;
- 1.6. “Pagesa bankare bilaterale” nënkupton një pagesë për pjesëmarrësin tjetër;
- 1.7. “Një pagesë bankare” nënkupton pagesën në mes një pjesëmarrësi në sistem dhe BQK-së;
- 1.8. “Netimi” përcaktimi i obligimeve neto të pagesave ose përcaktimi i vlerës përfundimtare neto të obligimeve të shlyerjes në mes të dy e më shumë pjesëmarrësve në sistem të pagesave;
- 1.9. “BQK” nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- 1.10. “Kliring” procesi i bartjes, barazimit, konfirmimit të instruksioneve për transfer të fondeve apo të letrave me vlerë para shlyerjes dhe përfshin netimin e udhëzimeve dhe krijimin e pozicioneve përfundimtare për shlyerje;
- 1.11. “EUR” nënkupton valutën EUR;
- 1.12. “Udhëzim” nënkupton një rekomandim me shkrim të lëshuar nga Banka Qendrore, që ka aplikim të përgjithshëm dhe është i detyrueshëm në tërësinë e tij dhe drejtpërdrejt i zbatueshëm;
- 1.13. “Urdhërpagesë” nënkupton çdo udhëzim nga paguesi apo i paguari dhënë institucionit të tij ose të saj të pagesave ku kërkohet ekzekutimi i transaksionit të pagesave;
- 1.14. “Transaksion i pagesës” do të thotë një veprim, i iniciuar nga paguesi ose i paguari për vendosjen, transferin apo tërheqjen e parave, pavarësisht nga ndonjë obligim përkatës ndërmjet paguesit dhe të paguarit;
- 1.15. “Llogaria për shlyerje” nënkupton llogarinë në EUR të cilën e ka hapur dhe e mban pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë në BQK për shlyerjen e transaksioneve të pagesave;
- 1.16. “Shlyerje” nënkupton aktin e shlyerjes së obligimeve me anë të transferit të fondeve, letrave me vlerë apo të instrumenteve të tjera financiare ndërmjet dy ose me tepër palëve;
- 1.17. “Procesori i palës së tretë” nënkupton ofruesin e mjetit për komunikimin e urdhërpagesave në emër pjesëmarrësve të sistemit;
- 1.18. “Data e vlefshmërisë” nënkupton ditën bankare në të cilën realizohet urdhërpagesa sipas urdhërit të dërguesit të saj;

### **Neni 3**

#### **Fushëveprimi dhe aplikimi**

1. Kliringu dhe shlyerja kryhet çdo ditë pune në Kosovë për këmbimin e urdhërpagesave lidhur me një pagesë apo pagesat bilaterale bankare.
2. Për të marrë pjesë në kliring dhe shlyerje, një urdhërpagesë ndërbankare do të sigurojë transaksionin e pagesës në emër të klientit apo pjesëmarrësit në sistem. Urdhërpagesa të cilën klienti ia paraqet drejtpërsëdrejti procesorit të palës së tretë, ashtu si është udhëzuar nga pjesëmarrësi, vlerësohet të jetë urdhërpagesë e vetë pjesëmarrësit në sistem, duke i zbatuar udhëzimet e klientit.
3. Pjesëmarrësit në kliring dhe shlyerje janë institucionet pjesëmarrëse të drejtpërdrejta, në sistem të pagesave ndërbankare shlyerjet ndërbankare të kliringut kryhen në llogaritë për shlyerje të pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë që mbahen në BQK.

### **Neni 4**

#### **Urdhërpagesat**

1. Urdhërpagesa duhet të përmbajë urdhërin e prerë dhe të pakushtëzuar për pagesë në EUR dhe mos t'i nënshtrohet kurrfarë kufizimi, përveç që mund të bëhet e vlershme në datën e kërkuar në procedurë operimi. Ajo duhet të përmbushë kriteret e kërkuara në procedurat e operimit dhe t'i adresohet pjesëmarrësit në sistem apo BQK-së.
2. Duke iu nënshtruar dispozitave të kësaj Rregulloreje, urdhërpagesa e cila përmbush kriteret e paragrafit 1 të këtij neni do të ekzekutohet nga BQK-ja duke regjistruar debi ose kredi në llogaritë për shlyerje. Secila urdhërpagesë e cila nuk përmbush kriteret e paragrafit 1 të këtij neni ose e cila nuk mund të sigurohet për shkak të të dhënave të pamjaftueshme dhe të pasakta, dështimit në vërtetimin ose çfarëdo arsye tjetër dhe secila urdhërpagesë e cila është dërguar gabimisht, në bazë të shifrës unike sortuese duhet të kthehet në bankën dërguese, që të ndahen për këtë qëllim nga secila bankë pjesëmarrëse.

### **Neni 5**

#### **Hapja dhe Mbajtja e Llogarive për Shlyerje**

Secili pjesëmarrës i drejtpërdrejtë që vepron në Kosovë, i cili merr pjesë në kliringun dhe shlyerjen e urdhërpagesave duhet të mbajë llogarinë për shlyerje në librat e BQK-së.

### **Neni 6**

#### **Pagesat në dhe prej llogarisë për shlyerje**

1. Për secilin pjesëmarrës në sistem pagesat në vijim, të inicuar nga një urdhërpagesë mund të bëhen në dhe prej llogarisë për shlyerje:
  - 1.1. Një pagesë bankare
  - 1.2. Pagesat bilaterale bankare

2. BQK-ja nuk do të debitojë llogarinë për shlyerje ose lejojë tërheqjen e parave të gatshme nga llogaria për shlyerje, përveç nëse ekziston bilanci i mjaftueshëm për ta mbuluar vlerën në debi ose të tërhequr.
3. Një pagesë bankare, siç është tërheqja e parave të gatshme do të vendoset nga BQK-ja në llogarinë për shlyerje të pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë. Pagesa prej llogarisë për shlyerje ndaj BQK-së kryhet duke regjistruar debi në llogarinë për shlyerje të pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë. Pagesa prej BQK-së në llogarinë për shlyerje kryhet duke regjistruar kredi në llogarinë për shlyerje.
4. Pagesa bilaterale bankare mund të iniciohet nga urdhërpagesa lëshuar BQK-së dhe udhëzimi për ta debituar llogarinë për shlyerje të pjesëmarrësit në sistem, që paguan dhe ta kreditojë llogarinë për shlyerje të pjesëmarrësit tjetër. Pagesa kryhet duke regjistruar debi në llogarinë për shlyerje të pjesëmarrësit në sistem, që paguan dhe kredi në llogarinë për shlyerje të pjesëmarrësit tjetër.
5. Debia apo kredia e regjistruar në llogarinë për shlyerje në përputhje me këtë pjesë bëhet përfundimtare, e pakthyeshme dhe e prerë, sapo të jetë konfirmuar me njoftimin, që BQK-ja ia ka dërguar secilit pjesëmarrës në një pagesë bankare apo pagesat bilaterale bankare, jo më vonë se në atë kohë pasi të jetë kryer kliringu ditor sikurse është përshkruar në procedurën e punës.
6. Pavarësisht nga paragrafi 7 i këtij neni dhe të nenit 7, paragrafi 2.2 të kësaj Rregulloreje, debia për tërheqje të parave të gatshme nga ndonjë pjesëmarrës i drejtpërdrejtë duhet të regjistrohet menjëherë nga BQK-ja në llogarinë për shlyerje të atij pjesëmarrësi dhe ajo aty për aty është përfundimtare, e pakthyeshme dhe e prerë.
7. Për secilin transaksion të pagesave, shlyerja finalizohet sapo që ndonjë debi apo kredi e regjistruar në llogarinë për shlyerje të ndonjë pjesëmarrësi, palë nga pagesa, bëhet përfundimtare, e pakthyeshme dhe e prerë.

## **Neni 7**

### **Urdhërpagesat e përpunuara nga BQK-ja**

- 1 Urdhërpagesën e cila e udhëzon BQK-në të paguajë një pagesë të vetme ose pagesë bilaterale bankare, ndonjë bankë mund ta parashtojë në mënyrë individuale ose si pjesë e ndonjë grupi.
- 2 BQK-ja do të ekzekutojë secilën urdhërpagesë e cila i paraqitet asaj:
  - 2.1 Vetëm nga fondet e gatshme në llogarinë e pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë që paguan, dhe
  - 2.2 Në çfarëdo kohe para përfundimit të kliringut ditor sikurse është specifikuar në procedurën e punës, ndërsa një urdhërpagesë me datë të vlefshmërisë sikurse është e përshkruar në procedurë të punës, duhet të ekzekutohet në datën e vlefshmërisë.

- 3 BQK-ja për pjesëmarrësin e drejtpërdrejtë i cili nuk ka mjete për të paguar urdhërpagesën nga llogaritë për shlyerje, do ta refuzojë urdhërpagesën ose ta vendosë në radhë dhe do ta njoftojë pjesëmarrësin. Urdhërpagesa e vendosur në radhë do të ekzekutohet nga BQK-ja sipas rendit të saj dhe pa paralajmërim vetëm kur mjetet e llogarisë për shlyerje, të pjesëmarrësit që paguan, janë të disponueshme. BQK-ja mund ta refuzojë urdhërpagesën e pa ekzekutuar në çfarëdo kohe para se ajo të jetë ekzekutuar dhe e njofton pjesëmarrësin për këtë. Urdhërpagesa e pjesëmarrësit e cila nuk është ekzekutuar e as nuk është refuzuar gjatë kohës së kliringut ditor, me veprimin e ligjit pezullohet në mbyllje të kliringut ditor sikurse është parashkruar në procedurën punuese.
- 4 Aty ku nuk ka mjete të gatshme për tërë urdhërpagesat e grumbulluara , për qëllimin e paragrafit paraprak, BQK-ja mund ta trajtojë secilën urdhërpagesë, si të përfshirë në grumbull pasi është transmetuar individualisht dhe e vendosë atë për ekzekutim në ngarkim të mjeteve të gatshme, pritje në radhë ose refuzim, në cilëndo sekuencë që asaj i duket e përshtatshme.
- 5 Përveç nëse refuzohet ose vihet në radhë për pritje nga BQK-ja sikurse është thënë në paragrafin 3 të këtij neni, urdhërpagesa e pjesëmarrësit e cila i është dhënë BQK-së është e prerë dhe pjesëmarrësi nuk mundet ta pezullojë atë. Për urdhërpagesën e cila pret në radhë, pezullimi nga pjesëmarrësi është i plotfuqishëm vetëm kur i është dhënë BQK-së në mënyrën, kohën dhe sipas procedurës së caktuar nga BQK-ja, që i mundëson asaj të veprojë para se të debitet llogaria për shlyerje e pjesëmarrës të drejtpërdrejtë.
- 6 BQK-ja do të refuzojë cilëndo urdhërpagesë e cila nuk është vërtetuar ashtu si duhet, përmban të dhëna të pamjaftueshme për pjesëmarrësin, për paguesin ose është në kundërshtim me këtë Rregullore.
- 7 Urdhërpagesa e pjesëmarrësit në sistem e cila është pezulluar ose refuzuar nuk mund të ekzekutohet përveç nëse i njëjti e paraqet rishtas si një urdhërpagesë të re.

## **Neni 8**

### **Pagesat me prioritet**

Pavarësisht nga neni 6 paragrafi 6 dhe neni 7 paragrafi 2.2, një procedurë e punës mund të lejojë që dërguesi, urdhërpagesën e cila është subjekt i kësaj Rregulloreje ta përcaktojë si “pagesë me prioritet”. Varësisht nga disponueshmëria e mjeteve në llogarinë për shlyerje të pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë, BQK-ja do t’i procesojë këto “pagesa prioritare” sapo t’i pranojë urdhërpagesat me këtë destinim. BQK-ja menjëherë do të bëjë regjistrimin e debisë ose kredisë rezultuese në llogarinë për shlyerje dhe për këtë fakt i njofton secilin nga pjesëmarrësit në një pagesë apo pagesë bilaterale bankare, pas së cilës debia ose kredia e regjistruar në llogarinë për shlyerje bëhet përfundimtare, e pakthyeshme dhe e prerë.

**Neni 9**  
**Udhëzimet**

Bordi Ekzekutiv i BQK-së miraton udhëzimet lidhur me zbatimin e kësaj Rregulloreje, përkitazi me procedurat e punës, duke i përfshirë specifikacionet për urdhërpagesat, oraret dhe procedurat të cilat drejtojnë kliringun dhe shlyerjen.

**Neni 10**  
**Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet**

Çdo shkelje e kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Sistemin e Pagesave.

**Neni 11**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Kliringun dhe Funkionimin e Llogarive për Shlyerje të BQK-së, e miratuar më 26 nëntor 2013 dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë Rregullore.

**Neni 12**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 prill 2015.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Bedri Peci